REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 345/23, 364/23
Datë/Datum. 14.07.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 345/23
364/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga, Kimete Gashi-Kryetare duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE "N.T.SH. Delfina" me seli në Malishevë, si dhe ankesën e OE G.I.Grafo – Loni" sh.p.k., me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me inventar shkollor për artikuj që nuk janë me AQP-në me nr. të prokurimit: 616-23-1251-1-2-1, iniciuar nga, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e autoritetit kontraktues, me 12.07.2023, mori:

V E N D I M

1.Hedhet poshtë si e palejuar, ankesa e operatorit ekonomik OE "N.T.SH. Delfina", e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datën 05/06/2023, numër protokolli 2023/0345, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me inventar shkollor për artikuj që nuk janë me AQP-në" me nr. të prokurimit: 616-23-1251-1-2-1, iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, pasi që OE ankues konsiderohet si palë pa interes juridik material, konform nenit 4 paragrafi 1.26 te LPP-së.

2.Aprovohet, si pjesërisht si e bazuar ankesa e OE "G.I.Grafo-Loni" sh.p.k., me nr. 2023/0364 , e datës 08/06/2023, ndërkaq mbetet ne fuqi vendimi i AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me inventar shkollor për artikuj qe nuk jenë me AQP-në" me numër të prokurimit 616-23-1251-1-2-1

3.Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4.Lejohet OE ankues, "G.I.Grafo-Loni" sh.p.k., dhe operatorit ekonomik ankues "N.T.SH. Delfina" kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës për sigurim të ankesës, konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP. Kurse, ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthim të mjeteve, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me datën 22.02.2023, AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës, ka publikuar njoftimin për kontratë, ndërsa hapja e ofertave është bërë me datë 17.03.2023. Me 24.05.2023, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me inventar shkollor për artikuj qe nuk jenë me AQP-në" me numër të prokurimit 616-23-1251-1-2-1,ku është rekomanduar për kontratë Grupi i Operatorëve Ekonomik "Tic-Log sh.p.k."& "Expoedio PR"& Commications Solutions" sh.p.k.

Me datë 26.05.2023, OE ankues "N.T.SH. Delfina", ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me datë 31.05.2023,AK-Komunës së Prishtinës, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar B58 Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 24.05.2023.

Me datë 26.05.2023, OE ankues "G.I.Grafo-Loni" sh.p.k ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-Komunës së Prishtinës, të cilën me datë 02.06.2023, AK e ka refuzuar si të pa bazuar dhe e ka vërtetuar B58 Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 24.05.2023.

Me datën 05.06.2023 OE ankues "N.T.SH. Delfina", ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 345/2023, kundër njoftimit mbi vendimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Me datën 08.05.2023 OE ankues "G.I.Grafo-Loni", ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 364/2023, kundër njoftimit mbi vendimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Elementet qenësore të këtij aktiviteti të prokurimit konsistojnë si në vijim: Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, çmimi më i ulët. Vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00€

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër është pranuar nga gjitha palët. AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës lidhur me raportin Nr/345/23,me datë 20.06.2023, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues ,ndërsa lidhur me ekspertizën e ekspertit Nr.364/23, nuk kemi deklarime te AK-së. Operatori ekonomik "N.T.SH. Delfina", nuk është deklaruar lidhur me raportin e ekspertit, ndërsa OE "G.I.Grafo-Loni" sh.p.k, me datë 19.06.2023, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Me datë 09.06.2023 OSHP ka angazhuar ekspertin e brendshëm shqyrtues të prokurimit që në pajtim nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 16 dhe 18.05.2023 ka rekomanduar që:

- Të hedhet poshtë si e palejuar ankesa e OE ankues "N.T.SH. Delfina" me seli në Malishevë,
- Të aprovohet si e bazuar ankesa e OE ankues "G.I.Grafo-Loni" me seli në Prishtinë,
- Të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK të datës 24.05.2023 dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim,(*njoftimi për dhënie të kontratës*).

-Seanca dëgjimore-

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

<u>Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "N.T.SH. Delfina" me seli në Malishevë</u>
<u>Përgjigje në pretendimi nr.1.</u>

OE "N.T.SH. Delfina"- Malishevë- pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës nuk e ka respektuar paragrafin 3,4,5 të nenin 10 të LPP-së.

Eksperti sqaron se qëllimi i këtij neni përkatësisht i këtyre paragrafëve është ofrimi i qasjes në dokumente zyrtare përveç atyre që janë sekrete afariste. OE ankues pretendon se AK ka shkelur këto paragrafe sepse qasja nuk ju ka ofruar në referencat e OE fitues.

AK ka sqaruar se referencat nuk i janë ofruar për qasje sepse të njëjtat janë konsideruar si sekrete afariste siç ka kërkuar OE i shpallur fitues duke e plotësuar aneksin 3 të DT për trajtimin e disa dokumenteve si sekret afarist e nderë to edhe referencat dhe i njëjti ka dhënë edhe arsyetim të bazuar se të njëjtat duhet te trajtohen si sekrete afariste ,arsyetimin e gjeni në aneksin 3 të dosjes së tenderit të plotësuar dhe të ngarkuar së bashku me ofertë nga OE i shpallur fitues.

Për ti hequr çdo dyshim pasi ne si ekspert kemi qasje të pa kufizuar në secilin dokument e ne rastin konkret edhe në referenca ju sqarojmë dhe konstatojmë se Grupi i OE i shpallur fitues e ka plotësuar ketë kriter dhe posedon referenca në harmoni me kërkesat e parapara me NJK dhe DT. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar

Përgjigje në pretendimi Nr.2

OE "N.T.SH. Delfina", Malishevë, pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës nuk e ka respektuar paragrafin 3,4,5 të nenin 11 të LPP-së.

Eksperti sqaron se për trajtimin e informatave sekrete afariste duhet plotësohen tri kritere e ato janë parapara ne nenin 11 në tri paragrafët si me poshtë:

3.1 që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji;

3.2 që operatori përkatës ekonomik t'i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t'i mbajë artikujt e tillë si sekret; dhe

3.3 kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik.

Eksperti sqaron se:

Pika 3.1 është përmbushur sepse referencat hyjnë te neni 69 te aftësia teknike dhe profesionale.

Pika 3.2 është përmbushur sepse OE i shpallur fitues e ka plotësuar aneksin 3 të dosjes se tenderit dhe nder tjera edhe referencat ka kërkuar të mbesin si sekret afarist.

Pika 3.3 është përmbushur sepse OE i shpallur fitues ka dhënë arsyetim se pse duhet te mbesin sekret afarist referencat si dëshmi referoju aneksit 3 te plotësuar nga OE i shpallur fitues. Andaj meqë janë plotësuar tri kriteret e parapara për trajtimin e dokumenteve sekrete afariste nuk kemi te bëjmë me shkelje te nenit 11 të LPP-së. Andaj, eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuare.

Përgjigje në pretendimi nr.3

OE "N.T.SH. Delfina"- Malishevë,, - pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës nuk e ka respektuar nenin 108 A të LPP-së. OE pretendon pa të drejtë ju ka hedhur kërkesa si e pa lejuar:

Eksperti sqaron se:

AK me datë 07.04.2023 rreth orës 13:34 h apo brenda orarit të punës e ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e AK-së. OE me datë 12.04.2023 rreth orës 19:15 h e ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim në platformën e-prokurimit.

Duke u bazuar në LPP-në, Neni 5 Kalkulimi i afateve kohore pika 1 këtij neni thotë afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Në bazë të Nenit 108/A të LPP-së, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, citojmë:

3.Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

pika 3.2 e këtij neni thotë : 3.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit dhe piken 8 të këtij neni thotë Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: dhe piken 8.1 të këtij neni thotë kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, e refuzon si të pa afatshme. Shih dispozitat te Rregullores nr.001/2022 për prokurim publik:

Eksperti sqaron shihë nenin 60.1 pika b. dhe 60.2 të e cila sqaron ketë pretendim si: Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore shihë pikat e theksuara:

b) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0).

60.2 Është përgjegjësi e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim që kërkesa të përgatitet dhe dërgohet në autoritet kontraktues para skadimit të afatit të fundit për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim. Nëse parashtruesi dështon të përgatitë dhe paraqesë kërkesën për rishqyrtim brenda afateve kohore për arsye të çfarëdo problemi teknik që ndodhë në dy (2) orët e fundit para skadimit të afatit të fundit për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim, përgjegjësia e dështimit mbetet tek parashtruesi i kërkesës.

Mbi ketë bazë eksperti sqaron se data 07.04.2023 është ditë 0(zero) dita kur u ngritë në platformë ligjvënësi e ka konsideruar se e njëjta ditë nuk numërohet pra është ditë (0)zero dhe afati fillon nga data 08.04.2023 dhe OE kishte afat për paraqitjen e Kërkesës për Rishqyrtim (5) ditë të plota pra deri me datën 12.04.2023 siç e përcakton nenin 5 i LPP-së, përkatësisht kalkulimin e afateve ,afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit.

Pra afati ka filluar të ecë nga data 08.04.2023 dhe ka përfunduar me datën 12.04.2023 në ora 16:00h ,dhe siç e ka sqaruar paragrafi 60.2 Nëse parashtruesi dështon të përgatitë dhe paraqesë kërkesën për rishqyrtim brenda afateve kohore për arsye të çfarëdo problemi teknik që ndodhë në

dy (2) orët e fundit para skadimit të afatit të fundit për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim, përgjegjësia e dështimit mbetet tek parashtruesi i kërkesës.

Mbi ketë bazë nuk qëndron pretendimi i OE ankues sepse kërkesa për rishqyrtim është parashtruar jashtë afatit ligjor dhe AK me të drejtë e ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim si të pa afatëshme -të pa lejuar.

Eksperti sqaron se Ankesa e dorëzuar në OSHP. Edhe pse është dorzuar brenda afateve ligjore e njëjta është pa efekt juridik pasi që kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar jashtë afateve ligjore .

Ketë e sqaron edhe KRPP me interpretim për rastet kur kërkesa për rishqyrtim është parashtruar dhe pranuar nga AK edhe pse ka qenë jashtë afatit ligjor kurse ankesa është parashtruar brenda afatit ligjorë shih interpretimin nga KRPP-ja e që është rast i ngjashëm:

2. 22.11.2022 Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) kërkon interpretim ligjor nga KRPP, në lidhje me nenin 108/A të LPP-ës (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve) dhe nenin 109 të LPP-ës (Afatet për Dorëzimin e Ankesës). Pyetja e institucionit në fjalë është parashtruar si në vijim: "Nëse një operator ekonomik, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues jashtë afatit ligjor, mirëpo autoriteti kontraktues e ka shqyrtuar kërkesën dhe ka nxjerr vendimin duke mos e marrur për bazë çështjen e afatit, por e ka refuzuar ankesën për arsye tjera se nuk është i përgjegjshëm. Pas marrjes së vendimit për rishqyrtim, operatori ekonomik i njëjtë e sjell ankesën në OSHP, brenda afatit 10 ditor për ankesë, pra brenda afatit ligjor prej momentit të marrjes së vendimit. Si të veprojmë ne? A duhet ta shqyrtojmë ankesën dhe pretendimet ankimore, edhe pse ankesa tek autoriteti kontraktues ka qenë jashtë afatit ligjor, por që për këtë çështje nuk e ka refuzuar autoriteti kontraktues. Apo duhet që të mos e shqyrtojmë fare, dhe ta refuzojmë si të palejuar, pasi që tek autoriteti kontraktues është parashtruar kërkesa për rishqyrtim jashtë afatit ligjor?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim:

Procedura e rishikimit në radhë të parë rregullohet me nenin 108/A (zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve) të LPP-së. Paragrafit 1 i këtij neni përcakton si në vijim:

"1.Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues..."

Ndërsa, paragrafit 3 i këtij neni afatet kohore për parashtrim të kërkesës për zgjidhje preliminare pranë Autoritetit Kontraktues i parasheh si në vijim:

"3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit;

në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti i prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim."

Mos respektimi i afateve kohore për dorëzim të kërkesës për rishqyrtim të vendimit, pran Autoritetit Kontraktues, sipas paragrafëve 8. dhe 8.1 të po këtij neni do të rezultojë me refuzim të kërkesës.

Pra paragrafi 8, nën paragrafi 8.1 i këtij neni përcakton si në vijim:

"8. Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:

kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni;

Bazuar në nenin 108/A:

OE, mund të vendos për një zgjidhje paraprake te mosmarrëveshjes pranë AK ndaj një vendimi të marrë nga vetë AK.

Në bazë të kushteve të parashikuara në paragrafin e mëparshëm, afati kohor për parashtrimin e kërkesës për rishqyrtim të vendimit të AK-ës është i pakundërshtueshëm.

Kur kërkesa për rishqyrtim nuk është paraqitur në afat të përcaktuar ligjor, AK do të refuzojë kërkesën.

Me nenin 108/A të LPP-ës nuk është e qartë nëse kërkesa për rishqyrtim pranë AK, është e detyrueshme ose jo në mënyrë që të paraqitet një ankesë në OSHP.

Neni 108 në fakt përshkruan të drejtën opsionale ("mund"), por duke lexuar nenin 109 të vetë LPP, kërkesa për rishqyrtim duket të jetë si një fazë e detyrueshme paraprake në mënyrë që të paraqitet një ankesë pranë OSHP-së.

Neni 109, paragrafët 1 dhe 2, në fakt parashikojnë që:

"1. Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

"2. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji."

Për më tepër neni 111, paragrafi 1, nën paragrafi 1.9 përcakton:

"1. Çdo palë e interesuar mund të dorëzojë ankesë në OSHP-së, sidoqoftë OSHP do të marrë masa vetëm nëse ankesa e tillë:

1.9 e ka të bashkangjitur një kopje të vendimit të miratuar nga autoriteti kontraktues gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A;"

Pra, nga leximi i përbashkët i dispozitave të përmendura më lart, është e qartë se shqyrtimi paraprak pranë AK në fjalë është një fazë paraprake e detyrueshme qe duhet te ndodh para parashtrimit të ankesës në OSHP.

Në rastin konkret Operatori Ekonomik ka paraqitur një kërkesë për shqyrtim tek autoriteti kontraktues, pas afatit të dorëzimit. Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar kërkesën dhe ka lëshuar një vendim refuzues duke mos marrë në konsideratë çështjen e afatit. Pas refuzimit të AK-së, OE ka paraqitur ankesë pranë OSHP-së, brenda afatit të caktuar.

Nga dispozitat e përbashkëta të dispozitave të përmendura më lart, është mjaft e qartë se vendimi i miratuar nga ana e AK-së në përputhje me nenin 108/A, është një kusht paraprak për paraqitjen e ankesës pran OSHP-së.

Në rastin konkret AK ka lëshuar një vendim, por ankesa është paraqitur pas skadimit te afateve kohore të parashikuara nga neni 108/A . Pra, në këtë rast AK është dashur që të zbatojë dispozitat e nenit 108/A, paragrafi 8.1 dhe të refuzoj kërkesën për rishqyrtim sepse është dorëzuar përtej afatit kohor të përcaktuar.

Në këtë rast vendimi i marrë nga ana e AK (përkundër faktit se afati kohor kishte skaduar) duhet të konsiderohet si jo efektiv, dhe OSHP-ja në përputhje me nenin 109 do të deklarojë ankesën si jo të pranueshme për shkak të vonesës në dorëzimin e ankesës pranë AK i cili vendim e bënë vendimin e vet AK si të paefektshëm.

Në përfundim OSHP duhet të refuzojë ankesën e dorëzuar nga OE duke deklaruar skadimin e afatit të parashikuar në nenin 108/A, paragrafi 3, të LPP-së, i cili në fakt përfaqëson një kusht të detyrueshëm paraprak për paraqitjen e një ankese pranë OSHP-së dhe ky skadim e bën të paefektshëm vendimin e lëshuar nga AK.

Eksperti sqaron se përveç dispozitave të theksuara më lart ,edhe mbi bazën e këtij interpretimi konstaton se pretendimi i OE ankues është i pa bazuarë. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

<u>Përgjigje në Pretendimi nr.4,5,6,7,8.</u>

OE "N.T.SH. Delfina"- Malishevë- pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës nuk e ka respektuar nenin 68,69,58 par 3,neni 36 të LPP-së, dhe neni 7.5 i rregullores për prokurim publik nr.82/2022 e datës 20.10.2022(te numri i rregullores e ka gabuar OE ankues duke e shënuar numrin e protokollit por është e kuptueshme)

OE ankues vetëm i ka ndarë dispozitat sepse pretendimet thellësisht i ka të njëjta për çështjen e referencave, Andaj për të gjitha këto pretendime i gjeni përgjigjejet të pretendimi 1,2 dhe pretendimi 3 të kësaj ekspertize.

Eksperti sqaron ,se edhe pse ankesa trajtohet si e pa lejuar mbi arsyet e dhëna në pergjigjëjen nr. 3 të njëjtat pretendime i ka shqyrtuar për shkak të korrektësisë dhe te gjitha pretendimet janë të pa bazuara d.m.th. edhe sikur të ishte dorëzuarë kërkesa për rishqyrtim brenda afateve te parapara rezultati do ishte i njëjtë. Andaj, eksperti konstaton se këto pretendime janë të pa bazuara.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar duke u bazuar në sqarimet e dhëna në përgjigjen në pretendimin numër tre (3) të kësaj ekspertize.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE Ankues G.I.Grafo – Loni" sh.p.k., me seli në Prishtinë

Përgjigje në pretendimi nr.1

OE "NTGI Grafo Loni sh.p.k.," Prishtinë-pretendon së Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës e ka shkelur nenin 1 të LPP-së.

Eksperti thekson se ndër tjera qellim i këtij neni është të sigurojnë mënyrë ma efikase ,me transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat që do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen, andaj trajtimi i OE, ankues si OE i eliminuar nuk është në harmoni me nenin 1 të LPP-së.

OE Ankues nder tjera pretendon se AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së pasi që nuk e ka shfrytëzuar në mënyrë efikase buxhetin e shtetit duke shpallur fitues OE me çmim më të shtrenjtë me vlerë prej 78,000.00€ ,i njëjti pretendon se oferta e tij ishte me çmim ma te lirë në vlerë 77,640.00€ dhe ishte ofertë që i ka plotësuar te gjitha kriteret e parapara me NJK dhe DT .dhe padrejtësisht u eliminua.

Eksperti sqaron se qëndron pretendimi i OE ankues sepse Oferta e OE ankues ishte oferta me çmim ma të lirë dhe e njëjta i kishte plotësuar të gjitha kriteret e parapara me NJK dhe DT dhe në kundërshtim me nenin 1 të LPP ishte eliminuar. Andaj ,eksperti konstaton se ky pretendim është i bazuar.

Përgjigje në pretendimi nr.2

OE"NTGI Grafo Loni" sh.p.k.,-Prishtinë, pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës e ka shkelur nenin 7 të LPP-së.

Eksperti thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni është që autoritetet kontraktuese duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit.

Nder tjera pretendimi i OE ankues ishte se : AK nuk ka vepruar në mënyrë të barabartë për faktin se edhe pse kemi kryer furnizime njëjta por edhe furnizime të ngjashme dhe nga dëshmitë e

prezantuara nuk mundë të thuhet se nuk janë furnizime të ngjashme përveç në raste kur ka tendenca për eliminimin e një OE.

Eksperti sqaron se qëndron pretendimi i OE ankues sepse i njëjti ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme se ka kryer furnizime të njëjta dhe furnizime të ngjashme apo ka dorëzuar ofertë në harmoni me kriterin e paparë me NJK dhe DT ,ndërsa sa i përket qëllimit të eliminimit se a është në mënyrë tendencioze apo nga bindja e AK është e pa mundur dhe jo në domenin e ekspertit por të organeve të tjera të vërtetohet se a kishte tendenca apo jo me rastin e vlerësimit. Andaj ,Eksperti konstaton se ky pretendim është i bazuar.

Përgjigje në pretendimi nr.3

OE "NTGI Grafo Loni" SH.P.K.- Prishtinë, pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës e ka shkelur nenin 59 të LPP-së.

Eksperti thekson se qellim i këtij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të Vlerësimit ,pasi ka pranuar kërkesën për rishqyrtim nga një OE tjetër AK i ka shqyrtuar pretendimet dhe e ka trajtuar si të bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe procedurën e ka kthyer në Ri-vlerësim. Eksperti sqaron kronologjinë e rastit të Vlerësimit dhe të Ri-vlerësimit :

Vlerësimi: Komisioni i vlerësimit në mënyrë unanime nga tre anëtaret e komisionit u pranua dhe u rekomandua për kontratë OE "NTGI Grafo Loni" sh.p.k dhe e njëjta ofertë u shpall fituese duke konstatuar se i ka plotësuar të gjitha kriteret e parapara.

AK ka pranuar një kërkesë për Rishqyrtim dhe e njëjte kërkesë u aprovua si e bazuar nga ZPP dhe lënda u kthye në rivlerësim. Komisioni për Ri-vlerësim nuk kishte mendim të njëjtë por japin këto rekomandime:

Kryesuesi i komisionit ka rekomanduar për kontratë operatorin "TIC LOG" SH.P.K., duke u bazuar në dokumentacionin e ofruar në ofertë. Anëtarja e vlerësimit ka rekomanduar operatorin ekonomik NTGI "Grafo Loni" sh.p.k. Anëtari i vlerësimit ka rekomanduar operatorin me ofertë më të lirë :NTGI Grafo Loni sh.p.k.

ZPP ka kërkuar që të respektohet vendimi i fundit nga ZPP-ja si dhe rekomandimi i kryesuesit të komisionit për vlerësim Arben Gashit, pra në bazë të ZPP-së dhe kryesuesit të komisionit të vlerësimit Arber Gashit rekomandohet për dhënie të kontratës Grupit të Operatorëve Ekonomik TIC LOG sh.p.k :Expedio PR&Comunications Solutions SH.P.K.me çmim më të ulët të përgjegjshëm 78,000.00€

Kriteri për te cilin është eliminuar OE ankues është si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional 1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme me vlerë minimale prej 100,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontratë.	Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1.Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te furnizimeve.

OE ankues pretendon se në listën e kontratave kemi ofruar furnizime të njëjta por edhe të ngjashme:

Eksperti sqaron se nga 19 kontrata që janë prezantuar në listën e kontratave, dy nuk ju kanë pranuar nga AK dhe ato janë:

1.Kontrata e lidhur me Komunën e Graqanicës me titull: "Furnizim me Rekvizita dhe pajisje sportive" si dhe

2.Kontrata e lidhur me Komunën e Prishtinës me titull: "Furnizim me pajisje inografike në objektet e Komunës së Prishtinës"

Sa i përket referencës se Komunës se Graqanices OE ankues ka prezantuar me ankesë specifikacionin teknik të kësaj kontrate;

Ky është specifikacioni të cilën e kemi ne kontratë me Komunën e Graqanices për referencën të cilën e keni refuzuar për kontratën me nr të prokurimit; GRA618-20-7875-1-2-1 të cilën mund ta verifikoni ne platformën e e-prokurimit dhe siç shihet 90% e pozicioneve janë mjete themelore Inventar të cilat si produkt bazik e kanë hekurin dhe regjistrohen ne e-Pasuri prandaj Kriteri nenin 9.1&9.2 ka qenë për Referenca për Kontrata të ngjashme dhe jo të njëjta ndërsa ju po kërkoni furnizime të njëjta ne kundërshtim me atë se çka shkruan ne Nenin 9.1&9.2.

Eksperti sqaron se më lart te ankesa janë bashkangjitur Specifikat për ketë kontratë te cilat mundë ti gjeni, por për shkak të volumit të madh te tyre po i përmendi vetëm disa nga to që dëshmojnë se hyjnë te kontratat e ngjashme me ketë aktivitet të prokurimit si : pozicioni 2 hekuri me dy lartësi ,pozicioni 3 paralelet, pozicioni 4 Tavolina Pingpongu komplet, pozicioni 5 Senduk Suedez ,pozicioni 6 Tra i ulet, pozicioni 7 tra i lartë ,pozicioni 9 Banka suedeze ,pozicioni 17 Stoli me dollapë ,pozicioni 21 tavolinë për bilardo ,te gjitha këto pozicione janë te ngjashme me aktivitetin e prokurimit „Furnizim me inventar shkollor për artikuj që nuk janë me AQP-në.

Eksperti sqaron se kjo kontratë gabimisht është konstatuar se nuk është kontratë e ngjashme sepse e njëjta sikurse u sqarua me pozicione hynë te kontratat e ngjashme dhe kriteri në NJK dhe DT nuk ishte kontrata te njëjta por siç u sqarua më lart kriteri ishte për kontrata të ngjashme andaj, kontrata e pranuara nga AK me rastin e vlerësimit dhe me ketë kontratë OE ankues e plotëson kriterin sepse ne 17 kontrata te pranuara nga AK vlera e tyre ishte: 74,639.31 kur ja shtojmë edhe ketë kontratë e cila ka vlerën 45,855.00€ d.m.th. e tejkalon vlerën e paparë prej 100.000.00€ andaj mbi ketë bazë eksperti sqaron se qëndron pretendimi i OE ankues se vlerësimi nuk ishte në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

OE ankues pretendon se : sa i përket referencës se Komunës së Prishtinës me titull: Furnizim me pajisje Inografike në Objektet e Komunës së Prishtinës ,është e çuditeshe se nuk është marrë për bazë kjo referencë për vet faktin se 95% e punimit te totemave janë metal dhe vetme 5% e saj është shtyp ndërsa nga ana e AK thuhet se nuk është referencë e ngjashme.

Eksperti sqaron se AK gabimisht është thirr vetme në titullin e kontratës dhe e ka refuzuar pa dhënë sqarime se pse kjo kontratë nuk është e ngjashme meqë e njëjta është për furnizime dhe siç e sqaron OE ankues 95% e punimit të totemave janë metal dhe vetme 5% e saj është shtyp.

Për të sqaruar më në detale këto pretendime duhet të sqarojë-të ndërlidhem edhe me Udhëzuesin nr.001/2023 për prokurim publik, se si e rregullon përcaktimin e kritereve dhe kjo ndërlidhet edhe me vlerësimin e tyre shihë nenin 9.12 te këtij udhëzuesi:

9.12 Parimet e përgjithshme që rregullojnë përcaktimin e kritereve të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit duhet të përcaktohen nga Autoritetet Kontraktuese në mënyrë që të garantojnë respektimin e parimeve të transparencës, mos-diskriminimit dhe trajtimit të barabartë. Për më tepër, duhet të sigurojnë një nivel të përshtatshëm konkurrence.

Rrjedhimisht, ato duhet:

- të rezultojnë si jo arbitrare. Nën diskrecionin e AK-së në përcaktimin e tyre (siç përcaktohet nga Neni 52.4 i LPP), nuk duhet të kenë në asnjë rast efektin e dhënies së një lirie të pakufizuar sipas zgjedhjes së autoritetit kontraktues. Përkufizimi i tyre në fakt duhet të sigurojë mundësinë e konkurrencës efektive, të mos krijojë efekte deformuese dhe të mos lejojë kurrfarë avantazhi për një konkurrent, duke respektuar një tjetër.

- të jenë të lidhura me lëndën e kontratës. Kriteret e vlerësimit, në përputhje me nenin 52.2 të LPP-së, duhet të konsiderohen të lidhura me lëndën e kontratës kur ato kanë të bëjnë me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen sipas asaj kontrate në çdo aspekt dhe në çdo fazë të ciklit të jetëgjatësisë së tyre, duke përfshirë faktorët e përfshirë në:

-procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose eksperti sqaron se kontrata te cilën AK nuk i ka konsideruar të ngjashme, procesin specifik e ka tregtimin dhe furnizimin, edhe aktiviteti i prokurimit „Furnizim me Inventar shkollor për artikujt që nuk janë me AQP-në "procesin specifik e ka tregtimin dhe furnizimin, andaj edhe nuk mundë të trajtohet se nuk është kontratë e ngjashme. Andaj ,eksperti konstaton se ky pretendim është i bazuar.

<u>Përgjigje në pretendimi nr.4</u>

OE NTGI "Grafo Loni" SH.P.K.-Prishtinë pretendon se Autoritetit Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës e ka shkelur nenin 60 të LPP-së.

Eksperti thekson se qëllimi i nenit 60 të LPP-së është vendosja e kriterit dhe se kriter i dhënies ishte Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Eksperti sqaron se qëndron pretendimi i OE ankues ,sepse OE ankues ishte ofertuesi i përgjegjshëm dhe kishte ofertuarë me çmim më të lirë nga te gjithë ofertuesit, OE ankues kishte dorëzuar ofertë që i plotëson të gjitha kriteret e parapara me NJK dhe DT dhe mbi bazën e këtij

kriteri kishte ofertuar me çmim më të lirë dhe e njëjta në kundërshtim me ketë nenë apo padrejtësisht ishte eliminuar. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

-Konstatimet e panelit shqyrtues-

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli, dhe si rrjedhojë ankesa OE ankues DN.T.Sh "Delfina" hudhet e jashtë afatëshme pasi AK me datë 07.04.2023 rreth orës 13:34 h apo brenda orarit te punës e ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e AK-së, ndërsa OE me datë 12.04.2023 rreth orës 19:15 h e ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim në platformën e e-prokurimit.

Duke u bazuar në LPP-në, Neni 5 Kalkulimi i afateve kohore pika 1 këtij neni thotë *"afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune"*. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Me tuje paneli sqaron se në bazë të Nenit 108/A të LPP-së, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, citojmë:

3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

pika 3.2 e këtij neni thotë : "3.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit dhe piken 8 të këtij neni thotë Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: dhe piken 8.1 të këtij neni thotë kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, e refuzon si të pa afatshme".

Po ashtu neni 60.1 pika b. dhe 60.2 të e cila sqaron ketë pretendim si: Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore shihë pikat e theksuara:

b) *Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit*

elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0).

Duke i analizuar në tërësi shkresat e kësaj lënde, parashtresat dhe veprimet e ndërmarra nga palët, Paneli Shqyrtues shqyrtoj te gjitha provat dhe shkresat e prezantuara lidhur me këtë procedurë të prokurimit, për të cilën paneli shqyrtues krijoj një pasqyrë edhe me të qartë në këtë çështje.

Paneli shqyrtues analizoi dhe shqyrtoj edhe ankesën e OE G.I.Grafo – Loni" sh.p.k. dhe ka ardh ne përfundim se :

Lidhur me pretendimin e pare dhe të katërtë PSH konstaton se kriter per dhënien te kontratës ka qene " tenderi i përgjegjshëm me çmim me te ulet".. PSH vlerëson se ky kriter është i pabazuar pasi OE i rekomanduar për kontratë është vlerësuar si i papërgjegjshëm dhe se OE ankues nuk ka përmbushur kërkesat te vendosura ne DT .

Lidhur me pretendimin e dyte ankimor ku OE ankues pretendon se AK nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së PSH vlerëson se janë respektuar te gjitha dispozitat ligjore të LPP_së nga ana e AK – së.

Lidhur me pretendimin e tretë ankimor ku OE ankues pretendon se AK nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së duke eliminuar OE ankues është eliminuar për shkak se nuk ka plotësuar kërkesat mbi mundësitë teknike dhe /ose profesionale PSH vlerëson se tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional 1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme me vlerë minimale prej 100,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontratë si dhe Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1.Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te furnizimeve, PSH vlerëson se kontratat e dorëzuara nga OE ankues i cili pretendon se janë të ngjashme me aktivitetin e prokurimit PSH konstaton se kontratat e dorëzuara nuk përmbushin kërkesat e vendosura në DT sepse si kontrata të ngjashme mund të konsiderohet vlera e tyre 74,639 € ndërsa pjesa tjeër e kontratave për vlera tjera nuk mund të konsiderohen si kontrata të ngjashme dhe mbi këtë bazë PSH vlerëson se OE ankues nuk e përmbush kriterin e kërkesës të vendosur sipas DT., andaj pretendimi ankimor është i pabazuar .

Andaj përfundimisht, duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë shtjelluar ne raportin e ekspertit shqyrtues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrë në ketë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më

transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Prandaj Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetare e Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, dhoma e shkallës së parë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK-Kuvendi i Komunës së Prishtinës,

1x1 OE-ve ankuese

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.